



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

## RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
<b>Lulzim Bajrami</b>	<b>03.01.2024</b>	<b>03.01.2024</b>	<b>2023/1056</b>

### BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 27.12.2023, OE “KROSA traffic signs” SH.P.K.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/1056, ë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE “Grup i Operatorëve Ekonomik PLUS TRADE L.L.C.; VIZIONLEDD GROUP SH.P.K.”-, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizimin, montimin dhe vendosjen e monitoreve digjital ne hyrje te qytetit” me nr. të prokurimit: "656-23-11775-1-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA FERIZAJ. Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure te hapur, furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: **76,148.36** €. Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

### DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

**Neni 1 i LPP-së Qëllimi Neni 6 i LPP-së Ekonomiciteti dhe Efikasiteti Neni 7 i LPP-së – Barazia në trajtimin/Jo – Diskriminues Neni 59 i LPP-së – Ekzaminimi, Vlersimi dhe Krahassimi i Tenderëve Neni 60 i LPP-së - Kriteret për dhënjen e Kontratës Neni 69 i LPP-së – Kapaciteti teknik dhe profesional Neni 108A i LPP-se – Zgjidhja e mosmarreveshjeve Neni 26.6 i Rregullores per Prokurim Publik**

AK-KOMUNA FERIZAJ, ne aktivitetin e prokurimit me titull: Furnizimin, montimin dhe vendosjen e monitoreve digjital ne hyrje te qytetit, , me nr.prokurimi 656-23- 11775-1-2-1 AK nuk i ka vleresuar ofertat konform kriterëve të njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit, pasi

qe i njejtë AK e ka rekomanduar per kontrate OE PLUS TRADE, i cili OE eshte i papergjegjshem pasi qe nuk e permbush kriterin e referencave sipas nenit 69 te LPP-se, pasi qe jane kerkuar referenca te ngjashme te Monitoreve Digjital, por OE i rekomanduar ka bashkangjitur ne dosje referenca te ndriqimit publik dhe montimit te trafostacioneve, e qe nuk jane referenca te ngjashme siq jane kerkuar te kriteret e dosjes se tenderit dhe se OE ne fjale ka qene dasht te anulohet e jo te rekomandohet per kontrate. AK ne kriteret e dosjes ka kerkuar kriteret te natyres se projektit e qe OE nuk i ka permbushur dhe se ka qene dasht te eliminohet nga ky aktivitet.

**KRITERET E KERKUARA TE DOSJES tek Kapaciteti teknik dhe professional jane:**

**Kapaciteti teknik dhe professional :**

**Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses shërbime të ngjashme, në 3 (tre) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë), në vlerë minimale prej 110000.00 €. Në rast të konzorciumit, lideri i grupit duhet të përmbushë së paku 60% të referencave të kërkuara më lartë**

**Dëshmia e kërkuar dokumentare**

**1.Lista e kontratave (e nënshkruar dhe e vëlosur), operatori ekonomik apo grupi i operatoreve ekonomik duhet të ofrojë listën e kontratave të realizuara gjatë tri viteve të fundit nga data e njoftimit për kontratë të këtij tenderi në origjinal, të nënshkruar dhe vëlosur nga OE, të dëshmuar me referenca apo raporte të pranimeve teknike të shërbimeve të cilat tregojnë vlerën, datën.Kur punë është kryer për ndonjë kompani private duhet të ofrohet edhe dëshmia nga banka për ato referenca.**

Lidhur me kriterin e kërkuar të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë të DT-së është kërkuar : "Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses shërbime të ngjashme, në 3 (tre) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë), në vlerë minimale prej 110000.00 €. Në rast të konzorciumit, lideri i grupit duhet të përmbushë së paku 60% të referencave të kërkuara më lartë",

AK ka bërë shkeljen e kriterëve të FDT-së dhe NJK-së pasi që e ka rekomanduar për kontratë një OE i cili nuk i plotëson kriteret e Dosjes sipas nenit 69 të LPP-së.

Pretendimi nr.1

1.GOE. PLUS TRADE LLC; VIZION LED në listën e projekteve ka prezantuar projekte të cilat nuk janë të natyres së ngjashme e që nuk ka qenë dasht të rekomandohet për kontratë, por të eliminohet si OE. Lidhur me kriterin e kërkuar të DT-së, shumë qartë kërkohej që në rast të ofertimit si Konzorcium Lideri i Grupit duhet të plotësojë 60% të referencave.

Në rastin në fjalë Kriteri i referencave është kërkuar 110,000 €, ku lideri duhet të plotësojë së paku 60% të referencave apo 66,000.00 € e që në rastin në fjalë, lideri ka prezantuar në dosjen e tij vetëm një referencë të ngjashme në Komunën e Kacanikut me vlerë 17,799.55 € me titull: Vënosja e tabelave digjitale MIRE SE VINI NE KACANIK. Pra, Lideri ka qenë dasht të plotësojë 66,000 €, kurse lideri ka prezantuar vetëm një kontratë 17,799.55 €.

Pra, kjo e dëshmon se Lideri i grupit nuk e plotëson kriterin e FDT-së, pasi që i njëjti nuk i

ploteson se paku 60% te referencave. Bazuar ne kriterin e kerkuar te DT-se, ky GOE eshte i papergjegjshem pasi qe nuk e ploteson kriterin e FDT-se sipas nenit 69 te LPP-se, Lista e kontratave - Referencave. AK duhet te eliminon GOE e jo ta shperblen me kontrate pasi qe nuk i ploteson kriteret e kerkuara dhe eshte i papergjegjshem. Neni 59.4 i LPP-se, thote shume qarte se:


Autoriteti kontraktues do te konsideroje nje tender si te pergjegjshem vetem nese tenderi ne fjale shte në perputhshmeri me te gjitha kerkesat e parashtruara në njoftimin e kontrates dhe në dosjen e tenderit Krahasimi I referencave, qe do tua prezantojme si prove marr nga google.com

AK per kete aktivitet ka kerkuar ;



GOE I rekomanduar ka ofruar projekte te ndriqimit publik, e qe nuk jane te ngjashme, ku kete e deshmojme me foto dhe shihet dallimi ne mes te Ndriqimit publik dhe monitorit digjital, e qe po e paraqesim kerkimin permes [www. google.com](http://www.google.com) SQARIM: Ana e majte Kerkesa e AK-se (te ngjashme), kurse ne anen e djathte oferta e GOE se rekomanduar (Ndriqim publik)

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “KROSA traffic signs ” SH.P.K.”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizimin, montimin dhe vendosjen e monitoreve digjital ne hyrje te qytetit” me numër të prokurimit: “656-23-11775-1-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA FERIZAJ



Poashtu edhe te kriteri Certifikata ISO 9001 2015, ju sqarojme se:

Pasi qe kriteri I DT-se ka qene: Certifikatat ISO ne emer te Operatorit Ekonomik ose grupit me te cilin konkuron . Sistemi i menaxhimit te cilesise ISO 9001 2015.

Ne rastin ne fjale vetem njeri nga OE e disponon kete certifikate, dhe nuk e disponon Grupi, dhe sipas kriterit te Dosjes e ben oferten e papergjegjshme, e jo te rekomandohet per kontrate.

Kete me se miri e sqaron neni 26.6 i Rregullores per prokurim Publik, i cili thote: 26.6 Çertifikatat për sigurimin e cilësisë, përmenden në nenin 70 të LPP-së dhe kanë për qëllim vërtetimin e përputhshmërisë së operatorit ekonomik me një numër të caktuar standardesh për sigurimin e cilësisë.

Nëse Autoriteti Kontraktues kërkon çertifikata të hartuara nga organe të pavarura që kryejnë aktivitete të certifikimit për të vërtetuar se operatori ekonomik përmbush standarde të caktuara për sigurimin e cilësisë që bazohen në standarde kosovare, evropiane ose ndërkombëtare, secili anëtar i grupit do të dëshmoj se i përmbush standardet përkatëse.

Pra, ne rastin ne fjale ky GOE i papergjegjshem e jo te rekomandohet per kontrate, pasi qe edhe vet kriteri i DT-se thote se Certifikatat ISO duhet ti deshmoje Operatori ose Grupi i Operatoreve, Pasi qe kriteri i DT-se ka qene: Certifikatat ISO ne emer te Operatorit Ekonomik ose grupit me te cilin konkuron . Sistemi i menaxhimit te cilesise ISO 9001 2015. Vet fjale Grupi i Operatoreve e deshmon se kete certifikate duhet ta plotesojne te dy OE te pjesemarres..

Kjo e ben oferten e tij te papergjegjshme, dhe ky GOE duhet te eliminohet e jo te rekomandohet per kontrate. Pretendimi nr.2 Poashtu edhe GOE SFINGA& LIMIT L&B - edhe ky GOE eshte i papergjegjshem per shkak se nuk i ploteson kriteret e DT-se, per kriterin e kerkuar te FDT-se. GOE SFINGA & LIMIT L&B ne listen e projekteve k ate perfunduar vetem nje project, te ngjashem me vlere prej 33,333.33 Euro, me titull: Ndertimi I mbishkrimeve digjitale ne hyrje te qytetit, me nr.prok.917-22-12863-5-2-1.

Sipas kriterit te kerkuar per liderin kerkohet qe lideri ti disponon se paku 66,000 Euro, kurse lideri ne fjale ka ofruar vetem projektin e lartecekur (33,333.33 Euro), qe nuk e ploteson kriterin e dosjes dhe eshte I papergjegjshem, pasi nuk ka perfunduar me shume se kete kontrate. Pra, GOE nuk e permbush kriterin e kerkuar te referencave siq e potencuam me larte. Edhe te kriteri I kerkuar Certifikata ISO, 9001-2015, ne emer te operatorit ekonomik, ose grupit me te cilin konkuron, sistemi I menaxhimit te cilesise, ISO 9001 2015, te ky kriter I dosjes, GOE nuk eshte I pergjegjshem per faktin se nuk e ploteson kriterin e kerkuar ne dosjen e tenderit per arsye se thuhet shume qarte:

Te operatorit ose te grupit te Operatoreve, qe ne rastin ne fjale, Certifikaten ISO e disponon vetem LIMIT L&B e cila nuk mund te vertetohet ne link: <http://eqsc-cert.org>, dhe mendojme se eshte certifikate e dyshimit pasi qe nuk mund te vertetohet permes sistemit elektronik (google.com). Poashtu partneri I grupit SFINGA nuk e disponon Certifikaten ISO 9001 2015, andaj ky GOE eshte I papergjegjshem sipas kriterëve te dosjes dhe ky GOE eshte I papergjegjshem dhe duhet te liminohet pasi qe si grup nuk disponojne te dy OE certifikatat ISO 9001 2015.

Bazuar ne nenin 59.4 te LPP-se: Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit Neni 26.6 I Rregullores per Prokurim Publik e sqaron shume qarte se: 26.6 Çertifikatat për sigurimin e cilësisë, përmenden në nenin 70 të LPP-së dhe kanë për qëllim vërtetimin e përputhshmërisë së operatorit ekonomik me një numër të caktuar standardesh për sigurimin e cilësisë.

Nëse Autoriteti Kontraktues kërkon çertifikata të hartuara nga organe të pavarura që kryejnë aktivitete të certifikimit për të vërtetuar se operatori ekonomik përmbush standarde të caktuara për sigurimin e cilësisë që bazohen në standarde kosovare, evropiane ose ndërkombëtare, secili anëtar i grupit do të dëshmoj se i përmbush standardet përkatëse. Pra, ne rastin në fjale ky GOE i papërgjegjshëm e jo të rekomandohet për kontratë.

AK ka shkelur nenin 59 të LPP-se, pasi që nuk i ka plotësuar kriteret e DT-se, duke mos i trajtuar referencat sipas kriterit të kërkuar. Poashtu ka bërë shkeljen e nenit 69 të LPP-se Kapaciteti Teknik dhe ose profesional dhe se ky GOE e lartëcekur duhet të elimonohet për arsye të sqaruara në brendi të kësaj ankese. AK ka shkelur dispozitat ligjore dhe për keto shkelje ne do të detyrohemi që të vazhdojmë me tutje për zbatimin e dispozitave ligjore sipas kriterëve të kërkuara të dosjes dhe njoftimit për kontratë Poashtu AK duke mos i trajtuar siq duhet kërkesën për rishqyrtim ka bërë shkeljen e paragrafit 10.2 të nenit 108/A të LPP-se, pasi që sipas provave të bashkangjitura AK ka qenë dësht të eliminon GOE e rekomanduar e jo të shpërblen me kontratë. Pra, AK nuk i ka trajtuar fare pretendimet tona ankimore dhe ka bërë shkeljen e dispozitave ligjore, e që keto prova ju si OSHP duhet të bëni zgjidhje konform dispozitave ligjore dhe kriterëve të DT-se..

Bazuar në pretendimet e larteshenuara kërkojmë nga ju si OSHP që të merrni parasysh ankesën tonë si të bazuar në fakte dhe prova.

Bazuar në pretendimet e cekura më lart i kërkojmë nga OSHP, që në lidhje me ankesën tonë të merr:

**V E N D I M A P R O V O J Ë si të bazuar ankesën e OE. KROSA Traffic Signs SHPK, dhe të**

**ANULOJ Vendimin e AK-se, i cili vendim është i pa bazuar në kriteret e DT-se, dhe përmes kësaj ankese kërkojmë që lenda të kthehet në RIVLERESIM, dhe gjatë rivleresimit të rekomandohet për kontratë pasi që ne si OE jemi i përgjegjshëm, ku i plotësojmë të gjitha kriteret e kërkuara të Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë.**

#### KRITERET PËR VLERËSIM

--

<p><b><u>Kapaciteti teknik dhe professional</u></b></p> <p>Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses shërbime të ngjashme, në 3 (tre) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë), në vlerë minimale prej 110000.00 €. Në rast të konzorciumit, lideri i grupit duhet të përmbushë së paku 60% të referencave të kërkuara më lartë</p>	<p><b><u>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</u></b></p> <p>1.Lista e kontratave (e nënshvulosur), operatori ekonomik operatoreve ekonomik duhet të kontratave të realizuara gjatë fundit nga data e njoftimit për kontratë në origjinal, të nënshkruara nga OE, të deshmuar me referencat e pranimeve teknike të shërbimeve tregojnë vlerën, datën.Kur punon për ndonjë kompani private duhet të ofrojë edhe dëshmia nga banka për ato kontratë</p>
<p>Certifikatat ISO në emer të Operatorit Ekonomik ose grupit me të cilin konkuron . Sistemi i menaxhimit të cilësive ISO 9001 2015.</p>	<p><b><u>Certifikatat valide dhe të noterizaur ne origjinal.</u></b></p>

## RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

### RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

#### DEKLARATË

Komisioni vlerësues, për dhënie të kontratës, rekomandon; Gr.i OE: "Plus trade" L.L.C. dhe "Vizion led d group" SH.P.K. është ofertues i përgjegjshëm dhe me çmimin më të ulët të ofruar.

## INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

--

## VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

--

## VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

--

## ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - " KROSA traffic signs " SH.P.K.

**Pretendimi nr.1:** Gt. i OE. PLUS TRADE LLC; VIZION LED ne listen e projekteve ka prezantuar projekte te cilat nuk jane te natyres se ngjashme e qe nuk ka gene dasht te rekomandohet per kontrate, por te eliminohet si OE.

**Përgjegjia e ekspertit shqyrtues ndaj pretendimit ankimor nr.1**

Eksperti shqyrtues konstaton dhe vërteton se ne dosjen e tenderit AK ka kërkuar: *Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses shërbime te ngjashme, në 3 (tre) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontratë), ne vlere minimale prej 110000.00 €.* Në rast të konzorciumit, lideri i grupit duhet të përmbush së paku 60% të referencave të kërkuara më lartë.

Operatororert ekonomik ofertues kan dorzuar ofertën si grup dhe te nejtut kan marrveshje te bashkëpunimit konform Nenit 71 te LPP dhe Dosjes se tenderti pikës 11.1.

## MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Në mes të:

1. **PLUS TRADE L.L.C.** me Numër unik identifikues 811451864, e përfaqësuar nga z. Përparim Dalloshi, Drejtor,
2. **"VIZIONLEDD GROUP SHPK"** me numër unik identifikues UNI: 811419482 e përfaqësuar nga znj. Qëndresa Januzaj, Drejtor.

Lënda e marrëveshjes së Bashkëpunimit të kompanive të sipërpërmendura është për tenderin:

Titulli: Furnizimin, montimin dhe vendosjen e monitoreve digjital ne hyrje te qytetit  
656-23-11775-1-2-1

Të cilat më tutje do të quhen si Anëtarë të Konzorciumit, kanë arritur marrëveshjen e mëposhtme:

### Neni 1

Anëtarët e konzorciumit (Grupi i operatorëve Ekonomik) është i njëzëshëm për themelimin e konzorciumit **PLUS TRADE L.L.C & VIZIONLEDD GROUP SHPK**, në tekstin e mëtejme "KONZORCIUMI" dhe do të ofrojnë ofertën përmes bartësit të konzorciumit për tenderin e shpallur nga **KOMUNA FERIZAJ**.

Titulli: Furnizimin, montimin dhe vendosjen e monitoreve digjital ne hyrje te qytetit  
656-23-11775-1-2-1

Emri i konzorciumit: **PLUS TRADE L.L.C.** & **"VIZIONLEDD GROUP SHPK"**

### Neni 2

Palët janë pajtuar që bartës i projektit të jetë partneri udhëheqës **PLUS TRADE L.L.C.** & i cili autorizohet që të firmosë të gjitha dokumentet në lidhje me tenderin dhe kontratën.

### Lider i grupit sipas marrëveshjes së bashkëpunimit mes operatoreve ekonomik është OE „PLUS TRADE L.L.C"

Duke pasur parasysh kërkesën e AK se OE duhet të ketë dëshmi për përfundimin e projekteve të ngjajshme në këto koncept në cilësinë e ekspertit shqyrtues gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të ofertës kam hasur në disa projekte të përfunduara nga ana e OE, liderit të grupit „PLUS TRADE L.L.C" dhe të cilat në cilësinë e eksperti konstatohet se janë të ngjajshme me konceptin e prokurimit, koncepti dhe qellimi i prokurimit ka të bëjë me qështje të instalimeve elektrike, dhe operatori ekonomik përkatësisht grupi i operatoreve ekonomik ka dorëzuar dëshmit si në vijim e të cilat janë të ngjajshme me natyrën e prokurimit:

### Kontratat dhe dëshmit e prezantuara nga lideri i grupit „PLUS TRADE L.L.C"

Rregullimi i ndriqimit publik ne Komunën e Kaçanikut, Vlera e projektit **104,647.50 euro**  
Vendosja e ndriqimit publik ne territorin e Komunës se Fushë Kosovës, Vlera e projektit **47,382.00 euro**

Rregullimi i ndriqimit publik ne Komunën e Kaçanikut, Vlera e projektit **73,555.00 euro**

Totali i projekteve te ngjajshme te prezantuara nga lideri i grupit është - **225,584.50 euro**

**Kontratat dhe dëshmit e prezantuara nga anetari i grupit „VIZIONLEDD GROUP SHPK „**

Kontrata me HIB PETROL e dëshmuar edhe me Fatura për TV DISPLAYIT ne vleren prej, **16,300 eruo**



23-PSV01-001-19

"VIZIONLEDD GROUP" SH.P.K

NRF: 811419482

Nrb: 811419482

Tvsh: 330449208

RR. TIRANA P.N - PRIZREN / KOSOVE

Tel: +38349300724

Email: vizionled@gmail.com

www.vizionled.com

Bleresi:

**HIB Petrol Corporation SH.P.K.**

Adresa: Tallinoc i Muhaxherëve, Magjistratja Ferizaj - Prishtinë, p.n Ferizaj Ferizaj

Telefoni: +38338777777

No fiskal: 812030493

Numri unik: 812030493

No TVSH: 330553819

Data	Kushtet	Validiteti	Referenca	Referenti juaj	Lokacioni
25.10.2023		25.10.2023			001

No	Kodi	Emertimi	Sasia	Njesia	Cmimi pa TVSH	Rabati %	TVSH %	Cmimi me TVSH	Vlera me TVSH
1	1292	TV DISPLAY P5 OUTDOOR	1.00	Copë	13,813.56	0.00	18.00	16,300.00	16,300.00

HIB PETROL - FERIZAJ 4. Nga dita e konfirmimit, parapagim 70% ne fillim te punimeve, ndersa 30% ne perfundim te punimeve.

Vlera pa TVSH : 13,813.56


Rabati : 0.00


TVSH : 2,486.44

**Vlera per pagese: 16,300.00 EUR**

**FATURA për kryerjen e furnizimeve me LED DISPLAY për Armotin SHPK ne vleren prej 15,000 euro**

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "" **KROSA traffic signs " SH.P.K.**", lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Furnizimin, montimin dhe vendosjen e monitoreve digjital ne hyrje te qytetit"** me numër të prokurimit: **"656-23-11775-1-2-1**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KOMUNA FERIZAJ**



  
20-SHV01-001-130

"VIZIONLEDD GROUP" SH.P.K.  
NRF: 811419482      Nrb: 811419482      Tvsh: 330449208  
RR. TIRANA P.N - PRIZREN / KOSOVE  
Tel: +38349300724      Email: vizionled@gmail.com      www.vizionled.com

**Bleresi:**

**ARTMOTION SH.P.K.**

Adresa: LIDHJA E PEJES,ZONA INDUSTRIALE

No fiskal: 810200866

Data fatura	Kushtet	Data e skadimit	User	Referenca	Referenti juaj	Lokacioni
08.12.2020		08.12.2020	Admin			001

No	Kodi	Emertimi	Sasia	Njesia	Cmimi pa TVSH	Rabati %	TVSH %	Cmimi me TVSH	Vlera me TVSH
1	105	LED DISPLAY	1.00	Copë	12,711.86	0.00	18.00	15,000.00	15,000.00

**Normat Tatimore**

	<b>Baza</b>	<b>TVSH</b>	<b>Vlera</b>
TVSH e llogaritur 0%	0.00	0.00	0.00
TVSH e llogaritur 8%	0.00	0.00	0.00
TVSH e llogaritur 18%	12,711.86	2,288.14	15,000.00

Vlera para zbritjes: 12,711.86

Rabati : 0.00

Vlera pa TVSH : 12,711.86

TVSH : 2,288.14

**Vlera per pagese: 15,000.00 EUR**

Pagesa: 0.00

Mbetja: 15,000.00

Anetari i grupi te konzorciumit **VIZIONLEDD GROUP SHPK** ka ofruar si dëshmi edhe disa fatura te këtyre natyrave.

Duke pasur parasysh këto ne cilesin e ekspertit shqyrtues konstatoj se lideri i grupit i cili është **PLUS TRADE L.L.C** ka prezantuar Kontrata, dhe referenca te ngjajshme ne vleren prej **225,584.50 euro** dhe i njeti arrin 60% e kërkuar për liderin sipas kerkeses se dosjes se tenderit, po ashtu anetari tjetër i grupit **VIZIONLEDD GROUP SHPK**, ka prezantuar disa Fatura dhe kontrata te natyrave te ngjajshme dhe konstatoj se grupi i operatoreve ekonomik i rekomanduar për dhënie ploteson këtë kriter e referencave te ngjajshme te keruara dhe pretendimi ankimo është i pa bazuar.

**Përgjegjia e Ekspertit lidhur me pretendimin ankimore per Certifikaten ISO 9001:2015, ne Dosjen e tenderit AK ka kërkuar:**

<p><b>Certifikatat ISO ne emer te Operatorit Ekonomik ose grupit me te cilin konkuron . Sistemi i menaxhimit te cilesise ISO 9001 2015.</b></p>	<p><b><u>Certifikatat valide dhe te noterizaur ne original.</u></b></p>
---	---

Pasur parasysh këtë ISO standatdet nuk lëshohen ne emer te grupit te operatoreve por lëshohen për operatorët, ne baze te marrveshjes s e konzorciumit mes operatoreve ekonomik, Nenin 2 i

kësaj marrvëshje percakton se lideri i grupit është **PLUS TRADE L.L.C** dhe i njeiti ka prezantuar **Certifikaten ISO 9001:2015 me nr.1710KS854Q.**

# Certifikatë

## Certificate

**Ky dokument konfirmon se Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë i**  
*This is to certify that the Quality Management System of*

**PLUS TRADE L.L.C.**

Rruga Gursel e Bajram Sylejmani, Ferizaj, Kosovë

**u vlerësua dhe u certifikua sipas**  
*has been assessed and found to conform to*

**ISO 9001:2015**

**Fusha e certifikimit/ Certification scope**

Ndërtimi i objekteve banesore dhe jobanesore. Instalime elektrike. Punime hidraulike, instalime të ngrohjes dhe kondicionimit të ajrit. Instalime të tjera ndërtimore. Punime suvatimi.

*Construction of residential and non-residential buildings. Electrical installation. Plumbing, heat and air-conditioning installation. Other construction installation. Plastering.*

**Certifikata nr.**

*Certificate no.*  
1710KS854Q

**Data e certifikimit në vazhdim**

*Date of current certification*  
10.11.2023

**Data e përfundimit të certifikimit**

*Date of expiry*  
09.11.2026

**Lëshimi aktual i certifikatës**

*Current issue of the certificate*  
10.11.2023

**CERTIFIKATË E VLEFSHME VETËM ME  
KUSHTIN E MBIKQYRJES VJETORE**

Viza Vjetore  
Deri Ne  
**Nëntor 2024**

Viza Vjetore  
Deri Ne  
**Nëntor 2025**

Lidhur me këtë është edhe interpretimi i **KRPP i dates 22.06.2023 nr.22 që sqaron këtë:**

" Në rast të kontratave për furnizime, kur Autoriteti Kontraktues kërkon dëshmi Certifikata të hartuara nga institutet zyrtare për kontrollimin e cilësisë që vërtetojnë përshtatshmërinë e produkteve që qartazi mund të identifikohen duke u bazuar në specifikimet dhe standardet përkatëse (neni 69, paragrafi 2, nen paragrafi 2.5 i LPP), **atëherë një dëshmi e tillë mjafton të sillet nga anëtari i grupit i cili do të kryej furnizimin, në mënyrë që të konsiderohet se kërkesa është përmbush nga grupi si tërësi.** Pa varësisht nga kjo, në rast se të gjithë anëtarët e grupit marrin pjesë në ekzekutimin e kontratës duke liferuar furnizime të prodhuara nga vetë ato, atëherë të gjithë anëtarët e grupit duhet të jenë të pajisur me certifikata të tilla, në mënyrë që AK të sigurohet se produktet e furnizuara janë të cilësisë sipas standardeve përkatëse të specifikuara në dokumentet e tenderit "

**Pretendimi nr.2.**Po ashtu edhe Gr. i OE SFINGA& LIMIT L&B edhe ky Gr. i OE eshte i papergjegjshem per shkak se nuk i ploteson kriteret e DT-se, per kriterin e kerkuar te FDT-se.

## **Përgjegjia e ekspertit shqyrtues:**

Ekspterti shqyrtues konstaton dhe vërteton se ne dosjen e tenderit AK ka kërkuar: *Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses shërbime te ngjashme, në 3 (tre) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë), në vlerë minimale prej 110000.00 €. Në rast të konzorciumit, lideri i grupit duhet të përmbushë së paku 60% të referencave të kërkuara më lartë.*

Operatororert ekonomik ofertues kan dorzuar ofertën si grup dhe te nejtit kan marrveshje te bashkëpunimit konform Nenit 71 te LPP dhe Dosjes se tenderti pikës 11.1.

### **(KONSORCIUM)**

#### **MARREVESHJE MIREKUPTIMI PER THEMELIMIN E PARTNERITETIT**

**E lidhur me datën : 15.11.2023**

Kompanise, "SFINGA" sh.p.k, me NUI : 810600280 në njerën anë dhe  
"LIMIT L&B" shpk - Prizren me numer te NUI: 810593617

Palet kontraktuese jane pajtuar qe te themelojne konsorciumin (partneritetin) per projektin : "Furnizimin, montimin dhe vendosjen e monitoreve digjital ne hyrje te qytetit " , me nr. Prokurimit : 656-23-11775-1-2-1, si Investitor : KOMUNA FERIZAJ

#### **NENI I. QELLIMI I THEMELIT TE MARRVESHJES**

Kjo marrveshje e bashkepunimit ndermjet kompanise "SFINGA" Sh.p.k Prizren , kompanisë "LIMIT L&B" shpk - Prizren ,eshte lidhur me qellim te themelimit te partneritetit lidhur me realizimin e projektit : "Furnizimin, montimin dhe vendosjen e monitoreve digjital ne hyrje te qytetit " , me nr. Prokurimit : 656-23-11775-1-2-1, si Investitor : KOMUNA FERIZAJ

#### **NENI II. OBJEKTI I MARRVESHJES**

Objekt i kesaj marrveshje jane te gjitha te drejtat dhe detyrimet e specifikuara me kete marrveshje,te cilat burojne si rezultat i mirekuptimit afarist midis paleve kontraktuese,dhe te njejtat konsiderohet se palet do ti zbatojne pa kurrfare reserve dhe keqinterpretimi,nga qasti i nenshkrimit te kesaj kontrate.

#### **NENI III. EMERTIMI I KONSORCIUMIT**

Palet kontraktuese respektivisht subjektet afariste ,deklarojne se jane pajtuar qe konsorciumi i dale nga kjo marrveshje ,te emerohet GOE "SFINGA" Sh.p.k Prizren & "LIMIT L&B" shpk - Prizren , Anetaret e konsorciumit: "SFINGA" Sh.p.k Prizren & "LIMIT L&B" shpk - Prizren ,jane pajtuar qe ky bashkepunim eshte i pershtatshem per strategjine e kompanive dhe eshte ne perputhje te plote me politikat e tyre afariste.

#### **NENI IV. BASHKEPUNIMI NDERMJET ANETAREVE**

Bashkepunimi ndermjet anetareve te konsorciumit do te bazohet ne ndertimin dhe mirebesimin e anetareve , duke u pajtuar per respektimin reciprok per te ofruar nje bashkepunim dhe nderveprim transparent , i cili bazohet ne doket e mira afariste , me qellim te arrijtes se zgjerimit sa me efikas te kapitalit te tyre.

#### **NENI V. VEPRIMI I ANETAREVE**

Anetaret e konsorciumit do te veprojn si nje kompani unike me nje structure integrale kur ato perfaqesojn interesat e tyre ,konform kufizimeve ligjore mbi themelimin e partneritetit afarist dhe kufizimeve tjera te cilat burojne nga kjo kontrate.Palet deklarojne se pajtohen me pergjegjesite dhe kufizimet qe dalin nga materiali i dosjes se tenderit ,listes se dokumentave qe kerkohen nga dosja e tenderit : "Furnizimin, montimin dhe vendosjen e monitoreve digjital ne hyrje te qytetit " , me nr. Prokurimit : 656-23-11775-1-2-1, si Investitor : KOMUNA FERIZAJ dhe te njejtat deklarojn njezeri qe do te bashkeveprojne me solidaritet ne ndihmen reciproke financiare dhe tekniko-profesionale deri ne perfundimine pergjegjsive lidhur me tenderin e siper theksuar.

#### **NENI VI KOHEZGJATJA E KONSORCIUMIT**

Anetaret e konsorciumit pajtohen qe ne kohe te arsyeshme do te kontribuojn me qellim te zhvillimit te afazizmit te tyre .Palet 10 dite pas perfundimit te punimeve ,respektivisht dorezimit te shërbimeve ,do te vendosin nese do te jene me tutje te perfshire ne partneritetin dhe menyren e organizimit qe buron nga kjo kontrate.Pas kalimit te ketij afati njera pale nuk mund te detyroj palen tjetër qe te perfshihet ne konsorcium pa pa pelqimin e saj te lire,pamashtrim dhe dhune.

#### NENI VIII. PERFAQESIMI I KONSORCIUMIT

Palet kontraktuese pajtohen qe partneri LIDER i grupit te jete antari - kompania "SFINGA" sh.p.k Prizren, respektivisht perfaqesuesi i sajë, dhe i njeiti autorizohet qe si partner udheheqes ka te drejten e firmos te gjana dokumentet ne lidhje me tenderin e lartepermendur, duke perfshire kontraten dhe shkresat tjera qe derivojne si rezultat i puneve tjera juridike. Pagesat dhe transakcionet tjera do te behen ne llogarine financiare te paraqitur ne dosjen e tenderit

### Lider i grupit sipas marrveshjes se bashkëpunimit mes operatoreve ekonomik është OE „SFINGA SHPK PRIZREN"

Duke pasur parasysh kërkesën e AK se OE duhet te ketë dëshmi për përfundimin e projekteve te ngjajshem ne këto koncept ne cilesin e ekspertit shqyrtues gjatë shqyrtimit te dokumentacionit te ofertës kam hasur ne disa projekte te përfunduara nga ana e OE, liderit te grupit „SFINGA SHPK PRIZREN" dhe te cilat ne cilesin e eksperti konstatoj se janë te ngjajshme me konceptin eprokurimit, koncepti dhe qellimi i prokurimit ka te bëj me qështje te instalimeve elektrike, dhe operatori ekonomik përkatësisht grupi i operatoreve ekonomik ka dorzuar dëshmit si ne vijim e te cilat janë te ngjajshme me natyren e prokurimit:

### Kontratat dhe dëshmit e prezantuara nga lideri i grupit „ SFINGA SHPK PRIZREN"

Furnizmi me sinjalistikë horizontale dhe vertikale - AK - NNP.Banesore Prishtinë, Vlera e projektit **21.122.00 euro**

Sinjalizimi rrugë dhe sistemi i unifikuar i adreave - AK - K.Suharekë, Vlera e projektit **70,787.00 euro**

Sinjalizimi Horizontal dhe Vertikal - AK-K.Obiliq, Vlera e projektit **9,250.60 euro**

Ndërtimi i mbishkrimit digjital ne hyrjen e qytetit - AK- K.Shtime, vlera e projektit **33,333.33 euro**

Totali i projekteve te ngjajshme te prezantuara nga lideri i grupit është - **134,492.93 euro referenca dhe kontrata te ngjajshme sipa skeresave te DT-së**

Duke pasur parasysh këto ne cilesin e ekspertit shqyrtues konstatoj se lideri i grupit i cili është **SFINGA SHPK PRIZREN** ka prezantuar Kontrata, dhe referenca te ngjajshme ne vleren prej **134,492.93 euro** dhe i njeti arrin 60% e kërkuar për liderin sipas kerkeses se dosjes se tenderit, dhe pretendimi ankimo është i pa bazuar.

**Përgjegjia e Ekspertit lidhur me pretendimin ankimore per Certifikaten ISO 9001:2015, ne Dosjen e tenderit AK ka kërkuar:**

**Certifikatat ISO ne emer te Operatorit Ekonomik ose grupit me te cilin konkuron . Sistemi i menaxhimit te cilesise ISO 9001 2015.**

**Certifikatat valide dhe te noterizaur ne origjinal.**

Pasur parasysh këtë ISO standatdet nuk lëshohen ne emer te grupit te operatoreve por lëshohen për operatorët, ne baze te marrveshjes s ekonozorciumit mes operatoreve ekonomik, Nenin 2 i kësaj marrveshje percakton se lideri i grupit është **PLUS TRADE L.L.C** dhe i njeiti ka prezantuar **Certifikaten ISO 9001:2015 me nr.0199**



**European Quality & Safety Control (EQSC)**

Ky dokument është lëshuar në bazë të Sistemit të Certifikimit të EQSC dhe Standardit përkatës.

Vlefshmëria e kësaj certifikate mbahet nëpërmjet auditimeve rregullshme vjetore dhe auditimit të ri-certifikimit në çdo tre vjet.

EQSC rezervon të drejtën të çrëhojë këtë certifikatë sipas kushteve të përçaktuara në Sistemin e tij të Certifikimit.

# CERTIFIKATË

**European Quality and Safety Control (EQSC)**

lëshon këtë certifikatë për

**Limit L & B sh.p.k**  
 Nr. 20, Rr. Xheladin Hana  
 20000 Prizren, Kosovë



Duke konfirmuar zhvillimin dhe zbatimin efektiv të  
**SISTEMIT TË MENAXHIMIT TË CILËSISË**

Në përputhje me kërkesat e Standardit Ndërkombëtar:  
**ISO 9001:2015**

**Për fushën e aktivitetit:**  
 Punë Ndërtimore, Sinjalistikë Rrugore, Dysheme industriale dhe Sportive, Kulme, Tregëturi tregtare dhe aditivë betoni.

EA: 28, 29

Numri i certifikatës:	0199
Data e Certifikimit fillestar:	25/11/2019
Data e fundit:	24/11/2023
E shërbues dhe audit:	24/11/2023
Numri i Rikerkimit:	NA





77,102,7 Viteve 6  
 Data e fundit: 22/06/2019

European Quality & Safety Control (EQSC): Rr. Sulajm Pasha, Pallat 20/1, Kat 1, Nr.1, 1016 Tirana, Shqipëri Tel: +355 4 222 7674, E-mail: info@eqsc-cert.org, www.eqsc-cert.org

Lidhur me këtë është edhe interpretimi i KRPP i dates 22.06.2023 nr.22 që sqaron këtë:

" Në rast të kontratave për furnizime, kur Autoriteti Kontraktues kërkon dëshmi Certifikata të hartuara nga institutet zyrtare për kontrollimin e cilësisë që vërtetojnë përshtatshmërinë e produkteve që qartazi mund të identifikohen duke u bazuar në specifikimet dhe standardet përkatëse (neni 69, paragrafi 2, nen paragrafi 2.5 i LPP), **atëherë një dëshmi e tillë mjafton të sillet nga anëtarë i grupit i cili do të kryej furnizimin, në mënyrë që të konsiderohet se kërkesa është përmbush nga grupi si tërësi.** Pa varësisht nga kjo, në rast se të gjithë anëtarët e grupit marrin pjesë në ekzekutimin e kontratës duke liferuar furnizime të prodhuara nga vetë ato, atëherë të gjithë anëtarët e grupit duhet të jenë të pajisur me certifikata të tilla, në mënyrë që AK të sigurohet se produktet e furnizuara janë të cilësisë sipas standardeve përkatëse të specifikuara në dokumentet e tenderit "

Eksperti shqyrtues sqaron, se autoritetet kontraktues janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marr në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP- së, autoriteti kontraktues duhet të këtë ne konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikas, më transparent dhe më të drejt të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike.

--

#### REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke pasur parasysh pretendimet ankimore ne cilesin e ekspertit shqyrtues kam shqyrtuar dhe kontrolluar ter dokumentacionin e ofertave dhe kriterëve te dosjes se tenderti dhe konstatoj se ankesa e operatorit ekonomik eshte e pa bazuar dhe rekomandoj PSH.OSHP qe te njeten ta refuzoj si te pa bazuar.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KOMUNA FERIZAJ**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP**
- OE ankues – **" KROSA traffic signs " SH.P.K.**

**Lulzim Bajrami**

